

FLOOR

PRODUKTET PËR SHTRIMIN E
DYSHEMESË

KATALOGU



**FUQIA ËSHTË
NË DUART
TONA**

FLOOR

PRODUKTET PËR SHTRIMIN E
DYSHEMESË



Përdorim i shpejtë
dhe i thjeshtë



Fortësi e lartë



Me kalim të shpejtë



I përshtatshëm për
ngrohje nën dysheme

BK-Liv 30

Masa vetëniveluese me tharje të shpejtë

Përdorimi: Masa vetëniveluese me ngurtësi të lartë dhe tharje të shpejtë, për nivelimin e sipërfaqeve prej betoni, lustrave/shtresave të çimentos dhe sipërfaqeve nën pllaka para vendosjes së parketit, qeramikës, PVC-së dhe dyshemeve të tjera në banesa, hapësira komerciale etj. Ky produkt nuk përdoret si shtresa e fundit. Trashësia e aplikimit është 5-30 mm. Përdoret në sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme (p.sh. tarraca ose ballkone në kombinim me shtresat hidroizoluese BK-HidroStop). E përshtatshme për sistemet e ngrohjes nën dysheme.

Përgatitja dhe vendosja: Nënshtrësia në të cilën kjo masë aplikohet duhet të jetë e ngurtë dhe e pastër dhe të mos ketë pluhur ose grimca të lidhura dobët. Para aplikimit të BK-Liv 30, nënshtrësia duhet trajtuar me astarin BK-Ultra Prime, ndërsa në rast të aplikimit mbi pllaka qeramike të vjetra, mund të përdoret BK-Bond si nënshtrësë. Koha e tharjes së nënshtrësës është së paku 4 orë. Masa përgatitet duke shtuar pluhur në 19-20% ujë, deri në homogjenizimin e plotë. Masa lihet të qëndrojë për afërsisht 5 minuta dhe pastaj përzihet përsëri. Masa aplikohet në një shtresë, duke përdorur një vegël të përshtatshme dhe, pas aplikimit të masës, është e dëshirueshme që sipërfaqja të përpunohet me një rul me gjilpëra (rul iriq) për të mënjanuar flluskat e ajrit. Masa e përgatitur duhet të përdoret brenda 45 min. Për udhëzime të hollësishme, shihni Fletën e të Dhënave Teknike të Produktit.

Shpenzimi: Afërsisht 1,5-1,7 kg/m²/mm.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 12 muaj në paketimin origjinal, në një hapësirë të thatë, mbi paleta.

Paketimi: 25 kg



Fortësi e lartë



Aderim i mirë në
nënshtrësë



Përdorim i shpejtë
dhe i thjeshtë



I përshtatshëm për
ngrohje nën dysheme

BK-Liv 10

Masa vetëniveluese për dysheme

Përdorimi: Masa vetëniveluese me ngurtësi të lartë, për nivelimin shtresëhollë të sipërfaqeve prej betoni dhe këmishëzave/shtresave prej çimentoje para ngjitjes së parketit, qeramikës, PVC dhe dyshemeve të tjera në banesa, hapësira komerciale etj. Ky produkt nuk përdoret si shtresa e fundit. Shtresa duhet të ketë një trashësi midis 2 mm dhe 10 mm. Koha e tharjes është 12 orë për çdo milimetër të trashësisë. Përdoret për sipërfaqe të brendshme dhe të jashtme (në rast të sipërfaqeve të jashtme përdoret në sistem me shtresat hidroizoluese BK-Hidrostop). E përshtatshme për sistemet e ngrohjes në dysheme.

Përgatitja dhe vendosja: Nënshtrësia në të cilën kjo masë aplikohet duhet të jetë e ngurtë dhe e pastër dhe gjithashtu të mos ketë grimca të lidhura dobët, yndyrë dhe pluhur. Para aplikimit të masës BK-Liv, sipërfaqja duhet të impregnohet me astarin BK-Bond të holluar sipas udhëzimeve. Masa përgatitet duke shtuar pluhur në 21% ujë, deri në homogjenizimin e plotë. Sigurohuni që ta respektoni përqindjen e rekomanduar të ujit, sepse ndonjë shmangie mund të ndikojë në cilësinë e masës BK-Liv. Lini masën që të qëndrojë për 5 minuta dhe pas kësaj e përzieni përsëri. Masa aplikohet në dysheme dhe shtrihet me ndihmë të një përdafi të dhëmbëzuar, me kujdes të veçantë në qoshe. Pas shtrirjes së masës, është dëshirueshme që sipërfaqja të krihet me një rul me gjilpëra (rul iriq) për të mënjanuar flluskat e ajrit. Për udhëzime të hollësishme, shihni Fletën e të Dhënave Teknike të Produktit.

Shpenzimi: Afërsisht 1,4-1,5 kg/m² në varësi nga trashësia e shtresës.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 12 muaj në paketimin origjinal në ambient të thatë në paleta.

Paketimi: 25 kg



BK-ParketFix Prime

Shtresë poliuretane monokomponente

Përdorimi: Shtresë njëkomponentëshe prej poliuretani pa ujë në bazë trëtësi, për përdorim të brendshëm. Përdoret për përforcimin e sipërfaqeve minerale dhe përmirësimin e ngjithshmërisë para ngjites së parketit me ngjitësin prej poliuretani BK-ParketFix PU. Lagështia e lejueshme e sipërfaqes para aplikimit të shtresës nuk mund të tejkalojë 3%. Shtresa është e përshtatshme për të gjitha sipërfaqet minerale, siç janë sipërfaqet prej betonit, llaçi prej çimentoje, sipërfaqet në bazë anhidriti etj.

Pergatitja dhe përdorimi: Sipërfaqja, në të cilën kjo shtresë aplikohet, duhet të jetë e fortë, e pastër, e thatë, pa vaj, yndyrë dhe materiale të tjera. Shtresa nuk mund të hollohet. Aplikohet me furçe ose rul me fibra të shkurtra, në mënyrë të uniforme në një shtresë e hollë. Në rast të nënshtresave me absorbim të lartë, aplikimi përsëritet me një interval prej 2-3 orësh. Parketi ngjitet pas tharjes së plotë të veshjes (- 12 orë). Për udhëzime të hollësishme, shihni Fletën e të Dhënave Teknike të Produktit.

Temperatura e aplikimit: Midis +10°C dhe +25°C, me një lagështi maksimale të ajrit prej 60%.

Shpenzimi: Afërsisht 0,15-0,30 kg/m² në varësi nga niveli i absorbimit dhe lloji i sipërfaqes.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: Deri në 9 muaj në paketimin original. Të ruhet në temperaturën nga +5°C deri +25°C, e mbrojtur nga drita e diellit dhe ngrirja.

Paketimi: 5 kg



Për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm



Gati për përdorim



Aderimin e përmirësuar



BK-Parket Fix

Ngjitës për parket



Për parketin me
gjatësi deri 400 mm



Ngjitje e shkëlqyer



Fleksibilitet të mirë



Eko miqësore

Përdorimi: Ngjitës sintetik me bazë emulsioni polimer që ka për qëllim ngjitjen e parketeve klasikë dhe laminatë në sipërfaqe çementoje, betoni dhe druri. Karakterizohet me ngjitshmëri të shkëlqyer mbi sipërfaqe dhe fleksibilitet të mirë.

Pëgatitja dhe vendosja: Sipërfaqja në të cilën vendoset ngjitësi duhet të jetë e fortë, e pastër, e thatë dhe pa mbetje vaji dhe boje të vjetër. Para vendosjes së parketit duhet bërë grundimi i sipërfaqes me BK-ParketFix të holluar me rreth 30 % ujë. Sipërfaqet çementoje nuk duhet të kenë më shumë se 3 % lagështi, ndërsa parketi jo më shumë se 8 %. Sipas nevojës ngjitësi mund të hollohet me një sasi të vogël uji deri 1 %, në mënyrë që të përshtatet trashësia. Ngjitësi aplikohet në sipërfaqe me një mistri me dhëmbë, me trashësi të dhtrësës 3-5 mm. Masa të vendoset mbi sipërfaqe dhe të shtypet mirë. Lëmimi i parketit mund të bëhet të paktën 24 orë pas ngjitjes. Për udhëzime më të detajuara shikoni fletën teknike të produktit.

Temperatura e përdorimit: Nga +5°C deri +25°C.

Shpenzimi: Rreth 1-1.2 kg/m², në varësi të llojit të sipërfaqes.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: 12 muaj në paketimin original. Të ruhet në temperaturën nga +5°C deri +25°C, e mbrojtur nga drita e diellit dhe ngrirja.

Paketimi: 5; 8 i 25 kg

BK-Parketfix PU

Ngjitës poliuretan më dy komponentë për parket



Përdorimi: Ngjitës poliuretan me dy komponentë, i cilësisë së lartë, me fortësi të madhe fillestare dhe përfundimtare, pa ujë dhe hollues, për përdorim të brëndshëm. Është i përshtatshëm për ngjitjen e të gjitha llojeve të parketeve, laminateve, dyshemeve me dërrasa, dhe parketeve me dru egzotik (me ngjitje provë) në sipërfaqe thithëse dhe jothithëse. Për shkak të ngjitjes së mire dhe fleksibilitetit është i përshtatshëm për vendosjen e parketeve në sipërfaqe ku ka ngohje të dyshemesë.

Pëgatitja dhe vendosja: Sipërfaqja në të cilën vendoset ngjitësi duhet të jetë e fortë, e pastër, e thatë, pa pluhur, mbetje vaji, yndyre dhe materialesh të tjera dhe e grunduar me BK-ParketFix Prime. Sipërfaqet nuk duhet të përmbajnë më shumë se 2% lagështi (rekomandohet matja e mëparshme). Para përdorimit, sasinë e përgjithshme të komponentës B (e cila gjendet në shishe) të hidhet në komponentën A dhe mirë të homogjenizohet. Komponentët të përzihen me mikser me numër të vogël rrotullimesh deri sa të arrihet një masë homogjene. Ngjitësi të vendoset me një spatul me dhëmbë të tipit B3. Materialet për dysheme të vendosen mbi ngjitësin e njomë dhe të shtypen mbi sipërfaqe. Ato mund të lëmohen jo më parë se 24 orë pas ngjitjes. Mjetet të pastrohen menjëherë pas mbarimit të punës. Për udhëzime më të detajuara shikoni fletën teknike të produktit.

Vërejtje: Vini re kohën e lidhjes së ngjitësit e cila është 60-75 minuta. Nuk lejohet përzierja e komponentëve në një marrëdhënie arbitrare.

Temperatura e përdorimit: Nga +10°C deri +25°C. Koha e lidhjes dhe tharjes së ngjitësit zgjatet në temperaturat e ulëta dhe shkurtohet në temperaturat e larta.

Shpenzimi: Rreth 0,9-1,3 kg/m², në varësi të materialit dhe të sipërfaqes.

Kohëzgjatja dhe ruajtja: Deri në 12 muaj në paketimin original. Të ruhet në temperaturën nga +5°C deri +25°C, e mbrojtur nga drita e diellit dhe ngrirja.

Paketimi: 10,5 kg (komponentë A+B)



Fortësi e lartë



Fleksibilitet i lartë



I përshtatshëm për
ngrohje nën dysheme





Banja Komerc Bekament DOO

Arandjelovac, 34304 Banja, Serbia

Tel: +381 34 6777 500; Faks: +381 34 6777 506

www.bekament.com